

**RREGULLORE E GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

“PËR KOMUNIKIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE ME MEDIAN”

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

1. Kjo rregullore përcakton parime, rregulla dhe procedura të veçanta për sa i përket vendosjes së një komunikimi të ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Gjykatës Kushtetuese me median vizive, të shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.
2. Komunikimi në kuptimin e kësaj rregulloreje përfshin të gjitha mënyrat e shkëmbimit të informacionit në formë të shkruar ose figurative, me foto apo video, si edhe në formë të dhënash statistikore.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 32, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Administratës së Gjykatës Kushtetuese, Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Kodit të Etikës të gazetarit.

**Neni 3
Fusha e veprimit**

Dispozitat e rregullores zbatohen për marrëdhënien dhe komunikimin e Gjykatës Kushtetuese me median, me qëllim garantimin e qëndrimit institucional të Gjykatës, rritjen e transparencës dhe promovimin e veprimtarisë së saj.

**Neni 4
Parimet e komunikimit me median**

Në zbatim të parashikimeve të Kodit të Etikës së Medias Shqiptare dhe rekomandimit 1215 (1993) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Etikën në Gazetari dhe Rezolutës 1003

(1993) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Etikën në Gazetari,¹ parimet e së drejtës së aksesit të medias në informacion janë:

- a) parimi i respektimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe mosndërhyrjes në funksionin gjyqësor;
- b) parimi i respektimit të solemnitetit të procedurave gjyqësore dhe autoritetit të drejtësisë;
- c) parimi i mbrojtjes së të dhënave personale;
- ç) parimi i prezumimit të pafajësisë;
- d) parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe sigurisë kombëtare;
- dh) parimi i objektivitetit, saktësisë, besueshmërisë, ndershmërisë, përgjegjësisë së raportimit korrekt të lajmit dhe moskeqdashësisë;
- e) parimi i së drejtës së korrigjimit dhe përgjigjes;
- ë) parimi i qasjes në informacion dhe mbështetjes për raportimet nga media;
- f) parimi i respektimit të dinjitetit të gjyqtarëve dhe përdoruesve të gjykatave;
- g) parimi i parandalimit të ndikimit paragjykses;
- gj) parimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në funksion të pajtimit të harmonishëm të vlerave dhe të rolit të lirisë së shtypit dhe drejtësisë si përbërës thelbësor i një shoqërie të lirë dhe demokratike;
- h) parimi i respektimit të të drejtave të tjera themelore të njeriut.

KREU II KOMUNIKIMI ME MEDIAN

Neni 5

Strukturat përgjegjëse për komunikimin me median të Gjykatës Kushtetuese

Strukturat e posaçme të komunikimit me median të Gjykatës Kushtetuese janë:

1. Kryetari dhe me autorizim të tij edhe Sekretari i Përgjithshëm;
2. Këshilltari për Median në Drejtorinë e Kabinetit të Kryetarit;
3. Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë.

Neni 6

Organizimi i komunikimit të Gjykatës Kushtetuese me median

1. Gazetarët kanë të drejtën të informohen në lidhje me veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese mundëson kushte të përshtatshme për gazetarët dhe operatorët në funksion të ushtrimit të misionit të tyre për informimin e publikut.
2. Gazetarët mund të akreditohen pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të paraqitjes së kërkesës me shkrim dhe dorëzimit të formularit të aplikimit shoqëruar me jetëshkrimin e tyre. Akreditimi bëhet bazuar në shkallën e mbulimit të medias në territor, profilin dhe përvojën e gazetarit, si dhe korrektësinë në përcjelljen e lajmit.²
3. Gazetarët e akredituar nënshkruajnë një deklaratë, sipas së cilës angazhohen për trajtimin e informacionit të marrë nga Gjykata Kushtetuese, në përputhje me kërkesat profesionale dhe parimet e kësaj rregulloreje.

¹Profesioni i tyre përfshin të drejta dhe obligime, të cilat gazetarët janë të detyruar t'i respektojnë në mënyrë që të përfitojnë mbrojtjen e duhur ligjore. Edhe Komisioni Evropian rekomandon që gazetarët të raportojnë në përputhje me parimet etike.

² Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, neni 6, pika 1.

4. Akreditimi i medieve të huaja bëhet pas akreditimit të tyre nga Ministria e Jashtme, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.
5. Gazetarët e tjerë, të cilët nuk janë të akredituar, por dëshirojnë të ndjekin seancat plenare publike, duhet të paraqesin kartën e gazetarit të medias që përfaqësojnë, duke plotësuar paraprakisht formularin përkatës bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
6. Kontaktet midis Gjykatës Kushtetuese dhe përfaqësuesve të medias realizohen nëpërmjet këshilltarit për median, i cili e ushtron detyrën nga ora 8:00-16:00 dhe mund të kontaktohet përmes telefonit dhe *e-mail*-it.
7. Këshilltari për median është përgjegjës për përgatitjen e informacionit që u vihet në dispozicion gazetarëve. Ai administron dhe trajton kërkesat për informacion për çështjet gjyqësore në shqyrtim, si dhe për kalendarin e seancave plenare të planifikuara.
8. Informacionet e përditësuara në lidhje me kalendarin e seancave plenare dhe informacionet e tjera për çështjet, vendimmarrjen dhe veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese publikohen në faqen zyrtare të internetit: www.gjk.gov.al

Neni 7

Informimi i medias përpara seancave plenare publike

1. Këshilltari për median vendos në dispozicion të medias informacionin e saktë teknik për seancat plenare në proces ose ato që planifikohen.
2. Informacioni për seancat plenare mund të merret 72 orë përpara datës së mbajtjes së tyre. Ai bëhet publik edhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese.
3. Me qëllim rritjen e transparencës dhe aksesit të plotë gjatë zhvillimit të seancave plenare publike, përfaqësuesit e medias dhe jo vetëm mund të ndjekin seancat në sallën e gjyqit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, nëpërmjet ekranit të vendosur në mjediset e akomodimit të gazetarëve ose nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë (*livestream*) të tyre.
4. Gazetarët që dëshirojnë të bëjnë regjistrime audiovizuale duhet të kërkojnë leje paraprake nga këshilltari për median, të paktën 48 orë përpara orës së caktuar për mbajtjen e seancës plenare publike, i cili përcakton me shkresë kushtet për të cilat jepet leja dhe detajet e tjera teknike.
5. Pasi media e ka marrë informacionin për datën e seancës, këshilltari për median mund ta informojë atë rreth aspekteve faktike dhe detajeve të tjera të seancës.

Neni 8

Pasqyrimi në media i seancave plenare publike

1. Gjykata Kushtetuese zhvillon seanca plenare publike, të cilat mund të ndiqen nga gazetarët për sa kohë nuk pengojnë zhvillimin normal të seancës plenare.³

³ Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, neni 6, pika 3.

2. Regjistrimet radiofonike, televizive, audio ose video nga përfaqësues të medias gjatë seancës plenare lejohen vetëm me pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese, në varësi të çështjes konkrete.⁴
3. Në respektim të rregullave të solemnitetit gjatë seancës plenare⁵, regjistrimet vizuale lejohen vetëm nga një pozicion i caktuar në sallën ku zhvillohet gjykimi, të përcaktuar nga këshilltari për median.
4. Përpara seancës plenare publike, këshilltari për median informon gazetarët për momentin e përshtatshëm kur ata do të kenë mundësi të bëjnë fotografi ose të regjistrojnë plane të ndryshme vizuale brenda sallës ku do të zhvillohet gjykimi.
5. Gazetarëve u lejohet të bëjnë regjistrime pamore të hyrjes zyrtare të trupës së gjyqtarëve në sallën e zhvillimit të seancave plenare publike dhe çeljes së seancës nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Më pas kamerat dhe mikrofonat fiken dhe këto mjete hiqen nga salla e zhvillimit të seancës plenare.
6. Gazetarët lejohen të dërgojnë mesazhe të shkruara (*sms*) nga pajisjet e tyre *mobile* gjatë seancës plenare, me kushtin që opsionet e zërit të këtyre pajisjeve të jenë të çaktivizuara. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mund ta kufizojë ose ndalojë këtë komunikim (me mesazhe të shkruara), nëse pengon zhvillimin normal të seancës.
7. Gjykata Kushtetuese mund të kufizojë numrin e ekipeve me kamera që do të lejohen në sallën e gjyqit në interes të zhvillimit të rregullt të seancës, me kusht që mediet që do të kenë akses, të bashkëpunojnë për t'u shpërndarë regjistrimet medieve të tjera.
8. Përveç regjistrimeve të përmendura më sipër nuk lejohet të bëhen regjistrime të tjera video (audio) në mjediset ku zhvillohet veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese.
9. Gjykata Kushtetuese do të monitorojë zbatimin korrekt të rregullave të komunikimit me median dhe do të marrë masat e duhura ndaj përfaqësuesve të tyre që shkelin këto rregulla, duke mbajtur parasysh natyrën dhe seriozitetin e shkeljes.

Neni 9

E drejta e akreditimit

1. Të drejtën e akreditimit e gëzojnë të gjitha mediat audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja, si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë.
2. Akreditimi jepet për:
 - a. gazetarë;
 - b. fotografë (fotoreporterë);
 - c. operatorë;
 - ç. kameramanë.
3. Kohëzgjatja e akreditimit në Gjykatën Kushtetuese mund të jetë:
 - a. ditore;
 - b. javore;
 - c. mujore;
 - ç. vjetore (vit kalendarik).

⁴ Ligji 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, neni 32, pika 4.

⁵ Ligji 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, neni 32, pika 3.

Neni 10

Pajisja me kartë akreditimi

1. Formulari i plotësuar për akreditimin i paraqitet këshilltarit për median, i cili kthen përgjigje brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga paraqitja.
2. Në rast të përmbushjes së kriterëve dhe dokumentacionit, personat pajisen me kartën e akreditimit të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës dhe të miratuar nga Kryetari.
3. Kur kërkohet nga institucioni mediatik, karta e akreditimit përmban: emër/mbiemër; institucionin mediatik që përfaqëson; periudhën e akreditimit; funksionin që mban personi; fotografi në përmasat 4x3; numrin rendor.
4. Karta e akreditimit për punonjësit e medias në profesion të lirë përmban: emër/mbiemër; periudhën e akreditimit; fotografi në përmasat 4x3; numrin rendor.
5. Personi i përcaktuar nga institucioni mediatik (gazetarë dhe operatorë) ose punonjësi i medias në profesion të lirë gjatë qëndrimit në Gjykatën Kushtetuese duhet të mbajë në vend të dukshëm dokumentin identifikues me emrin e medias nga e cila vjen dhe kartën e akreditimit pranë Gjykatës Kushtetuese.
6. Karta e akreditimit rinovohet me kërkesë të institucionit mediatik ose të vetë punonjësit të medias në profesion të lirë.
7. Këshilltari për median krijon regjistrin elektronik për personat e akredituar.
Regjistri elektronik përmban:
 - a. listën e mediave audiovizive, të shkruara dhe elektronike, të akredituara në Gjykatën Kushtetuese;
 - b. përfaqësuesit e tyre;
 - c. kohën e akreditimit;
 - ç. kontakte të nevojshme.
8. Karta e akreditimit rinovohet me kërkesë të institucionit mediatik ose të vetë punonjësit të medias në profesion të lirë.
9. Gazetarët e akredituar pranë Gjykatës Kushtetuese mund të zëvendësohen me kërkesë të saj ose të institucionit mediatik të cilit i përkasin. Për gazetarin e ri që akreditohet përsëritet e njëjta procedurë akreditimi si për gazetarin e mëparshëm.
10. Gazetari e humbet akreditimin për shkak të mosqenies më i punësuar apo pjesë e ekipit të institucionit mediatik nën të cilin është akredituar pranë Gjykatës Kushtetuese. Ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë për akreditimin nën një institucion tjetër mediatik ose si punonjës i medias në profesion të lirë.

Neni 11

Aktivite informuese

1. Gjykata Kushtetuese komunikon në mënyrë proaktive me median dhe organizon aktivite informuese për juridiksionin, vendimmarrjen dhe funksionimin e saj.
2. Strukturat e posaçme për marrëdhëniet me median përgatisin informacionin që u vihet në dispozicion gazetarëve, planifikojnë konferenca për shtyp dhe organizime të veçanta për median.

Këto struktura mbajnë dhe përditësojnë komunikimin e Gjykatës Kushtetuese edhe në rrjetet sociale, si LinkedIn, Twitter, Facebook, si dhe në çdo platformë tjetër të ngjashme.

Neni 12
Dispozita të fundit

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese.